




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.03.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-135/17, për z. Ramiz Kelmendi – Zëvendëskryeministër në Qeverinë e Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-135/17, për z. Ramiz Kelmendi – Zëvendëskryeministër në Qeverinë e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Pas informacioneve nga mediat se Kompania “Elkos” sh.p.k., me pronar z. Ramiz Kelmendi, ka përfituar Grante në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), në bazë të detyrës zyrtare, ka hetuar këtë rast për konflikt të mundshëm interesi.

AKK fillimisht ka bërë kërkesë në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë (AZHB) për të marrë informacione nëse në konkursin e fundit është në listën e përfituesve të Granteve kjo kompani dhe nëse është përfituese, a është tërhequr nga marrja e këtyre Granteve.

Në bazë të përgjigjes dhe dokumentacionit përcjellës që kemi marrë nga AZHB, Kompania “Elkos” sh.p.k., përmes përfaqësuesit të saj, ka aplikuar për Grante dhe është shpallur përfitues i mundshëm dhe gjendet në listën preliminare të publikuar me datën 20.10.2016. Kompanisë i janë paguar mjetet avans për projektin e saj prej 50 %, në vlerë prej 74,779.00 euro, mirëpo e njëjta, me datë 18.01.2017, përmes përfaqësuesit të saj, ka njoftuar AZHB-në se do të tërhiqet nga Granti dhe mjetet e lëshuara nga ana e AZHB – MBPZHR do t’i kthejë prapa.

Me datë 19.01.2017 Kompania "Elkos" sh.p.k. është drejtuar me kërkesë në kopje fizike për kthimin e mjeteve të marra avans ndërsa me datën 27.01.2017 Divizioni i Autorizimit ka pranuar konfirmimin bankar për kthimin e mjeteve nga kjo kompani.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji PKI), përveç tjerash, ndalon ushtrimin e funksioneve menaxhuese në biznese private, për zyrtarët e lartë publik, kategori kjo në të cilën hyn edhe Zëvendëskryeministri i Qeverisë.

Në mënyrë specifike, të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtarit të lartë në biznese private parashihen me nenin 15 dhe 16 të këtij ligji:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private" (neni 15, pika 1);

"Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj" (neni 16, pika 3).

Të gjitha këto obligime të përcaktuara me këto dispozita janë respektuar nga zyrtari i lartë z. Ramiz Kelmendi, në momentin që është larguar nga funksioni drejtues në ndërmarrjen "ELKOS" dhe ka bartur të drejtat e menaxhimit dhe drejtimit të ndërmarrjes tek "personi i besuar".

Mirëpo, shmangia e konfliktit të interesit nuk përfundon me kaq. Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga zyrtari i lartë nuk kanë kuptim në qoftë se ai nuk respekton kufizimet apo ndalesat tjera të Ligjit PKI. Një ndër këto kufizime është edhe ndalimi i lidhjes së kontratave me institucionet ku zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse.

Neni 15 (paragrafi 5) i Ligjit PKI parasheh se: *"Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhi kontratë ose të përfitoj ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse".*

Prandaj, shmangia e konfliktit të interesit, duke qenë pronar i kompanisë "ELKOS", krahas funksionit publik Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Kosovës është bërë me të drejtë, sepse zyrtari i lartë publik e ka obligim të parandaloj konfliktin e interesit bazuar në dispozitat e cituara më lartë.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtoria Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

